



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**  
**Nr. 135, Datë 09.07.2024**

**MBI**  
**LICENCIMIN E SHOQËRISË “5GX ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E**  
**PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/7prot., datë 04.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 855 prot., datë 03.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 12.04.2024, vendosi të filloje procedurën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.04.2024 dhe 15.04.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.04.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s. Gjithashtu me shkresën nr. 1030 prot., datë 02.05.2024, ERE ka njoftuar MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.
- Me shkresën me nr. 867/3 prot., datë 22.04.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Shoqëria me shkresat nr. 867/4 prot., datë

30.04.2024 dhe nr. 867/5 prot., datë 03.05.2024, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 91, datë 13.05.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin e mbetur për t’u plotësuar dhe depozitimin e tij në ERE.
- Pas shqyrtimit të informacionit/dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria, me vendimin nr. 114, datë 10.06.2024, ERE vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k., me qëllim dokumentimin e fillimit të punimeve dhe sqarimin/dokumentimin e shumës së disbursuar nga banka në kuadër të financimit të projektit, referuar faktit që shoqëria kishte parashikuar si datë të fillimit të operimit 01.07.2024.
- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 114/2024 me shkresën me nr. 866/5 prot., datë 14.06.2024. Shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 866/6 prot., datë 01.07.2024.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga analizimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “5 GX ENERGY” sh.p.k.:
  - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.06.2023 *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 10 MW, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier nga shoqëria “5GX ENERGY” shpk”;*
  - Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” marrëveshjen nr. 761/2 prot., datë 02.02.2023, për lidhjen e parkut fotovoltaik me rrjetin e shpërndarjes;
  - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 18.07.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaik 5GX ENERGY SOL PARK 10 MW”.
- Shoqëria ka dokumentuar aftësinë dhe mbështetjen financiare për realizimin e projektit sipas planit të saj të biznesit, si dhe ka depozituar kërkesën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për amendimin përkatës të Kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.06.2023, për sa i përket vlerës së investimit. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitohet në ERE qëndrimin e MIE-s dhe/ose amendimin përkatës të kontratës. ERE

rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit të licencimit në varësi të përcaktimeve të kontratës shtesë të koncesionit.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të Rregullores lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka informuar se jetëgjatësia e paneleve është 30 vjet, ndaj ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, pra për 30 vjet. Ky afat do të fillojë nga data e parashikuar nga shoqëria për operimin e centralit, pra nga data 01.08.2024.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 01.08.2024.
2. Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k. të depozitohet në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për kërkesën e bërë nga shoqëria për ndryshimin e vlerës së investimit të projektit.
3. Ky vendim është objekti i rishikimit nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**